



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikave

Shkup, 28 shkurt 2025

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: janar, 2025

- Në janar të vitit 2025, norma mesatare e interesit të totalit të kredive është ulur në nivel mujor dhe vjetor për 0,09 p.p., respektivisht 0,34 p.p., dhe është 5,21%. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave është 2,18% dhe është rritur për 0,01 p.p., respektivisht 0,46 p.p. në bazë mujore dhe vjetore.
- Norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara², në janar, shënoi rritje mujore prej 0,28 p.p. dhe është 4,70% me rënie vjetore prej 0,52 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave të sapo pranuar është 2,48% dhe është ulur për 0,30 p.p. në nivel mujor, ndërkah në nivel vjetor është rritur prej 0,26 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja në total

	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024	9.2024	10.2024	11.2024	12.2024	1.2025
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44	5.41	5.38	5.36	5.30	5.21
Korporatat	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20	5.15	5.09	5.05	4.96	4.85
Amviseritë	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66	5.66	5.66	5.66	5.63	5.55
Kreditë e reja	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04	4.98	4.81	4.82	4.42	4.70
Korporatat	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90	4.78	4.65	4.68	4.39	4.65
Amviseritë	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28	5.27	5.17	5.03	4.47	4.76
Depozitat	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96	2.01	2.07	2.12	2.17	2.18
Korporatat	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20	2.34	2.42	2.68	2.69	2.69
Amviseritë	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93	1.97	2.02	2.05	2.10	2.11
Depozitat e reja	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43	2.60	2.84	2.80	2.78	2.48
Korporatat	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99	2.14	2.75	2.43	2.59	2.56
Amviseritë	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76	2.79	2.89	2.88	2.83	2.46

Burimi: BPRM-ja.

¹ Me "normë interesi" nënkuptohet norma e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf


² Në lidhje me normat e interesit të kredive të sapo miratuara / depozitave të sapo pranuar janë karakteristike lëvizje të ndryshueshme. Lëvizjet e këtyre normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e re e rënë dakord e interesit.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikave

1. Normat e interesit në sektorin korporativ³


- Në janar, norma mesatare e interesit e totalit të kredive të sektorit korporativ arrin 4,85% dhe shënon rënie mujore prej 0,11 p.p. E analizuar sipas valutave, ndryshimi në rënie është rezultat i rënies së normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,46 p.p.) dhe normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,32 p.p.), gjatë rritjes së normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,02 p.p.). E analizuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit është ulur për 0,59 p.p.




Burimi: BPRM-ja.



- Norma e interesit të kredive të sapo miratuara të sektorit korporativ, këtë muaj, është më e lartë për 0,26 p.p. në bazë mujore dhe është 4,65%. Njëkohësisht, ndryshimi është në tërësi është rezultat i rritjes së normave të interesit për kreditë në denarë pa klauzolë valutore (për 0,39 p.p.), ndërsa normat e interesit për kreditë në valutë të huaj dhe normat e interesit për kreditë në denarë me klauzolë valutore janë ulur (për 0,46 p.p., respektivisht 0,11 p.p.). Norma e interesit e kredive të sapo miratuara të sektorit korporativ është ulur për 0,56 p.p. në bazë vjetore.



Burimi: BPRM-ja.




³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jofinanciare (publike dhe të tjera).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikave

- Në janar, norma mesatare e interesit e totalit të depozitave të sektorit korporativ është e pandryshueshme në bazë mujore dhe është 2,69%. Në bazë vjetore, kjo normë e interesit është rritur për 0,62 p.p.
- Norma e interesit e depozitave të sapo pranuar⁴ në sektorin korporativ, këtë muaj, shënoi rënie mujore prej 0,03 p.p dhe është 2,56%. E analizuar sipas valutës, ndryshimi mujor është rezultat i uljes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,12 p.p.), në kushtet e rritjes së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,19 p.p.). Këtë muaj, te bankat dhe kursimoret nuk janë regjistruar depozita të sapo pranuar në denarë me klauzolë valutore. Krahasuar me janar e vitit të kaluar, norma e interesit për depozitat e sapo pranuar për sektorin korporativ është rritur për 0,54 p.p.

2. Normat e interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRM-ja.



- Në janar, norma e interesit e totalit të kredive të amvisërive është 5,55% dhe është ulur për 0,08 p.p. në bazë mujore. Ndërkaq, rënia është rezultat i rënies për të gjithë komponentët dhe atë: normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,14 p.p.), normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,11 p.p.) dhe normat e interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,01 p.p.). Në bazë vjetore, norma e interesit e totalit të kredive të amvisërisë është më e ulët për 0,10 p.p.


⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵ Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikave

- Norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara të amvisërive, këtë muaj, realizoi rritje prej 0,29 p.p. në bazë mujore dhe shënon 4,76%. Njëkohësisht, rritja është rezultat i rritjes së normave të interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,13 p.p., respektivisht 0,08 p.p.), gjatë uljes së normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,17 p.p.). Krahasuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit është ulur për 0,50 p.p.



Burimi: BPRM-ja.



- Norma e interesit e totalit të depozitave të amvisërive, në janar, është 2,11% dhe shënoi rritje mujore prej 0,01 p.p. Ndryshimi në tërësi është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,03 p.p.), në kushte të uljes së normave të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore dhe të depozitave në valutë të huaj (për 0,66 p.p., respektivisht 0,02 p.p.). Në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është rritur për 0,42 p.p.
- Në janar, te norma e interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive⁶ është vërejtur rënie mujore prej 0,37 p.p. dhe është 2,46%. Rënia mujore vjen si pasojë e normave më të ulëta të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,32 p.p.) dhe normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,29 p.p.). Këtë muaj, bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Në bazë vjetore, norma e interesit e depozitave të sapo pranuar të amvisërive është rritur për 0,16 p.p.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikave

Informacione mbështetëse

Seri kohore e të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 28 mars 2025 (mesatare referuese, përfshirë me shkurtin e vitit 2025).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02/3215-235, lokali 108/110.